



LE TË VIJË ÇFARË TË VIJË,
SE VEÇ E MIRA
VJEN PREJ TEJE!



POZITIVITETI
SJELL PAQE SHPIRTËRORE



QËNDRIMI I BESIMTARIT
NDAJ BEGATIVE TË ALLAHUT

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 5 (231), Maj, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

MYFTINIASHKODER1990

Zot, të qofshim falë!

*Zot, të qofshim falë, që me butësinë
Tënde, edhe pse jemi hutuar e
rrugëtojmë në devijim, vazhdon të na
begatosh me rizkun Tënd, të na falësh jetë,
dritën e syrit, frymën e shqisat, mendjen
e rrahjet e zemrës, çdo gjë të ditur e të
paditur për ne, si për të na thënë e rithënë:
“Nga po shkoni?”, teksa Madhëria Jote
na dëshmon nëpërmjet gjuhës së Ma të
Dashtunit Pejgamber: “Robi Im! ... nëse ti
më vjen duke ecur, Unë të vij me vrap!”...*



NË TË GJITHA XHAMITË E SHKODRËS U FESTUA MË MADHËSHTI FITËR BAJRAMI

Më 2 maj 2022, mijëra
besimtarë myslimanë
në të gjitha xhamitë e Shkodrës
kryen ritualet e Fitër Bajramit, që
është një nga festat më të mëdha
të fesë islame.

Ceremonitë më kryesore u
mbajtën në xhamitë “Ebu Bekër” dhe Parrucë për të falur namazin
Bajramit të Ramazanit.

Në xhaminë e Parrucës Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B.
Sytari ka uruar, që në këtë festë të shenjtë besimtarët
të manifestojnë bashkim, dashuri dhe falje...



(f. 10)

MYFTIU I SHKODRËS, VIZITË KORTEZIE KRYETARIT TË RI TË BASHKISË SHKODËR

Paraditën e të enjtes, më
19 maj 2022, Myftiu
i Shkodrës, Imam Muhamed
B. Sytari, zhvilloi një vizitë
kortezie në zyrën e kryetarit të
ri të Bashkisë Shkodër, z. Bardh
Spahia.

Myftiu i Shkodrës i përcolli kryebashkiakut urimet më të
përzemërta me rastin e zgjedhjes në drejtimin me përgjegjësi të
Bashkisë Shkodër.

Gjatë takimit, Myftiu konfirmoi dëshirën për të
vazhduar bashkëpunimin me Bashkinë e Shkodrës...



(f. 16)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

LE TË VIJË ÇFARË TË VIJË, SE VEÇ E MIRA VJEN PREJ TEJE!

Zot, të qofshim falë, që me butësinë Tënde, edhe pse jemi hutuar e rrugëtojmë në devijim, vazhdon të na begatosh me rizkun Tënd, të na falësh jetë, dritën e syrit, frymën e shqisat, mendjen e rrahjet e zemrës, çdo gjë të ditur e të paditur për ne, si për të na thënë e rithënë: “Nga po shkoni?”, teksa Madhëria Jote na dëshmon nëpërmjet gjuhës së Ma të Dashtunit Pejgamber: “Robi Im! ... nëse ti më vjen duke ecur, Unë të vij me vrap!”...

Sa jemi shëndosh e mirë, shpesh e harrojmë hakun e falënderimit, thjeshtë për shëndetin, pra, të themi: Falemnderit Zoti im, për shëndetin e mirë! Harrojmë...!? Po ato veç dy fjalë janë, jo dy vëllime recitim!? Ja pra, as ato nuk i themi, nga rëndesat e fjalëve të përditshme që marrim e japim...! (I ngrati ai që i harrohet falënderimi dhe mirënjohja në jetë!?)

A thua se kemi punët e krejt botës mbi supe... Pastaj, një lëvizje e vogël këtu e një atje, kur e gjejmë veten sërish në shtrat. Jo për të bërë gjumin e përditshëm a pushimet rutine, herë me rregull e herë pa të..., jo, jo! Sërish, diçka nuk shkon me shëndetin!

O Zot! Temperaturë, dhimbje, lodhje, sy që djegin, prishje e ekuilibrit të humorit, humbje e shijes, plogështi, marramendje, padurim... Allah, Allah...!

(Dhe një mori hamendësimesh, që sillen e vërtiten përreth mendjes, si për t'u dëshmuar aleatë të zellshëm të të padukshmes që na ka prishur siranë...!?)

Sërish në shtrat e sërish nevojtarë për t'u ngritur në këmbë, të shoqëruar nga dhimbja e fryma që na merret, drejt një vendi ku mund të merret abdes...,

drejt sexhades..., drejt kibles..., drejt namazit..., dhe, pa fjalë e mes dhimbjesh, zhgënjyer nga vetja, trokasim në dyert e mëshirës, duke thirrur Atë, që na ka garantuar (jashtë çdo merite nga ana e jonë), se dera do të hapet nëpërmjet një kodi ezelit, shumë të thjeshtë e të mbarë për këdo, pa përjashtim: “Lutmuni Mua, Unë do t'ju përgjigjem!”... e prerë: “Unë do t'ju përgjigjem!”.

I ngrati njeri, gënjehet pas hijeve të përkohshme, kapet pas tyre, i dorëzohet e gati-gati i shenjtëron, duke harruar Dhuruesin e jetës, Garantuesin e rizkut, Mbrojtësin nga çdo e keqe, Begatuesin me mirësi, Furnizuesin pa lodhje, Krijuesin e diellit dhe rrezes, hanës e feksimit të saj..., i ngrati, që s'zu mend një herë!

Sërish në shtrat, sërish në kllapat e pastrimit nga gjynahet, sërish përballë pasqyrës së të vërtetës së madhe; paafësisë për t'u përballur deri me një virus a infeksion, një mikrob a një krijesë krejtësisht të papërfillshme e thuajse inekzistente (që po të mos ishte sforcimi për të shpikur mikroskopë e pajisje të zhvilluara për mbikqyrjen dhe studimin e një bote të panjohur për shumicën dërrmuese, as që do dinim se çfarë po ndodh e çfarë kemi?!), krejt fillikat, si një udhëtar i izoluar në një korridor tranziti..., në një pritje të pakufizuar...

A do hapet dera? A do vazhdojë udhëtimi? A do vonohet dhe, për pasojë, shumë plane do prishen? A do anulohet? Çfarë ndodh më pas...? Krejt gajb! Gajb! E panjohur! E paditur! E pallogaritur!

Zot, të qofshim falë, që s'na braktis me mëshirën dhe bekimet e Tua, edhe kur më të dashurit e më të shtrenjtët lodhen, s'durojnë më, hutohen diku tjetër a me diçka larg nesh, ... dhe kanë të drejtë! Gjithkush sprovohet nga një mikrob, tamam si ari i pastër nga metali me ngjyrë...! Gjithkush sprovohet në një moment të papritur, si udhëtar i një korridor të heshtur e plot tension...!?

Zot, të qofshim falë, që me butësinë Tënde, edhe pse jemi hutuar e rrugëtojmë në devijim, vazhdon të na begatosh me rizkun Tënd, të na falësh jetë, dritën e syrit, frymën e shqisat, mendjen e rrahjet e zemrës, çdo gjë të ditur e të paditur për ne, si për të na thënë e rithënë: “Nga po shkoni?”, teksa Madhëria Jote na dëshmon nëpërmjet gjuhës së Ma të Dashtunit Pejgamber: “Robi Im! ... nëse ti më vjen duke ecur, Unë të vij me vrap!”...

Allah, Allah, të qofshim falë Zoti im!

Ty të takon falënderimi e, tek Madhëria Jote është prehja! Pastaj, le të vijë çfarë të vijë, se veç e mira vjen prej Teje!

LUTU, MBËSHTETUR NË PREKJET E QETA TË AKSHAMEVE...

Zot i gjithësisë, edhe pse gjuha është tharë nga mungesa e përmendjes së Emrit Tënd, kujtimi i faljes Tënde bëhet shpresë kthimi nga dyert e netëve me erë misku, që vjen nga horizontet e të Dashurve të Tu... Ata, që natës mbuluese i japin frymë ditësh me dritë të pastër nga Drita e Dashnisë Tënde, teksa të thërrasin në lutje bekimesh...

Çfarë vlere do të kishte malli, pa prekjet e mëshirës Tënde, që si rreze dielli depërtojnë në sipërfaqet e errësuar nga retë e ditëve të vërenjtura zyrtësisht, nga devijimi në rrugën e Dashnisë Tënde?

Si do të ishte zemra, pa ëmbëlsinë e përmendjes së Emrit Tënd, që sa herë shfaqet në horizontet e saj, ajo (e lumja ajo) nis të përpëlitet e të dridhet nga kujtimet e së shkuarës..., asokohe, kur Emrat e Tu, bënin tavaf përreth saj, duke i dhënë jetë, si Qabe e Madhnueshme...?

Si do të ishte bota ime pa përkujtimin e Zotërive, dyert e të cilëve, sa herë hapen, nga kujtimi i tyre, era e miskut vërshon duke mbushur gjithësinë me parfumin e Besëlidhjes, teksa më merr për dore drejt përmendjes Tënde...?

Ah, era e miskut të duarve, që hapin dyert e zemrave me prekje shëruese, me besë virdeh e lutje akshamesh, para duarve të Madhnisë Tënde, o Paqtues i zemrave, o Falës i hutimit, o Udhëzues drejt Paqes së përhershme, që buron nga madhështia e emrit Tënd, Es-Selâm...

Ah, era e kujtimeve, që si fëmijë i përmalluar për erën e miskut, më merr për dore drejt Derës së madhe të dhikreve, nga drita e të cilëve, nata bëhet ditë e, pelerina e natës kthehet në vel të bardhë mirësie, që mbulon pamjet, që perde zemrës i bëhen...

Ah, malli (e lumja zemër për prekjet e tij), në netët e heshtura, që dëgjojnë zërin e Mësuesit, teksa lutet në qetësinë e bardhësisë së tij për gjithësinë, rrethuar nga butësia e përgjigjeve të pashfaqura: “Amin”...

Zot i gjithësisë, edhe pse gjuha është tharë nga mungesa e përmendjes së Emrit Tënd, kujtimi i faljes Tënde bëhet shpresë kthimi nga dyert e netëve me erë misku, që vjen nga horizontet e të Dashurve të Tu... Ata, që natës mbuluese i japin frymë ditësh me dritë të pastër nga Drita e Dashnisë Tënde, teksa të thërrasin në lutje bekimesh...

Zot i Madh, e si të mos shpresojë zemra në faljen Tënde, kur në rrahjet e saj, Emri i Madhnisë Tënde rrjedh si burim Gjallnie, që lan çdo papastërti vdekjes...

O natë loti, që në heshtje rënkon hutimin e shkuar, lutu si zemër e penduar para duarve të Mbretit, që thërret përnatë me Madhështinë e dhuntive të Tij: “A kërkon kush falje që ta fal?”...

Lutu, mbështetur në prekjet e qeta të akshameve, lajmëtarëve besnikë të Dritës së zemrave, të veshura me virde bese, në pragun e lutjes së ezanit...

Lutu, se dera është hapur!

Imam Muhamed B. Sytari



PËR ATA QË MË PYESIN..!

Për ata që më pyesin! Unë nuk mund të ndryshoj mendime e vokacione, as për teologë-politologë sipërfaqësorë, as për teka vulgare të cilitdo opinionist, as për këtë e atë, që ndjehet i çliruar dhe i arritur kur përmend emrin tim në studio televizive e përtej tyre!

Mua Islamin, qytetarinë, atdhetarizmin e normat e ekuilibrave ndërfetarë nuk m'i mësojnë dot as ndonjë ish-koleg e koleg i Komunitetit Mysliman, as opinionistët me shokë, as klerikë tekanjozë, e përtej tyre!

Mua Islamin, qytetarinë, atdhetarizmin e normat e ekuilibrave ndërfetarë nuk m'i mësojnë dot as ndonjë ish-koleg e koleg i Komunitetit Mysliman, as opinionistët me shokë, as klerikë tekanjozë, e përtej tyre!

Përkundrazi, jua mësoj me shumë përkushtim e përlutje nëpërmjet ligjërimëve të mia plot pathos, botimeve të shpeshta, librave dhe studimeve të vazhdueshme, për të cilët këshillohem pa ndërprerje me ustallarët e dëshmuar të këshillës në rangje përtej provincave intelektuale e shpirtërore!

Kështu që, urimet dhe lutjet e mia për të gjithë janë: të keni shëndet të plotë mendor, vullnet për t'u rritur e zhvilluar në drejtim të shëndoshë, mbarësi e sukses për të shërbyer për të mirën e individit shqiptar, shoqërisë tonë e njeriut, cilitdo njeri, kudo qoftë e sido qoftë!

Të gjithëve bashkë, ju them, siç Kur'ani më edukon: SELAM!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

Shkodër, 24 maj 2022

**“SA JEMI SHËNDOSH
E MIRË, SHPESH
E HARROJMË HAKUN
E FALËNDERIMIT, THJESHTË PËR
SHËNDETIN, PRA, TË THEM:
FALEMNDERIT ZOTI IM,
PËR SHËNDETIN E MIRË!”**





Imam Didmar Faja
Imam, UICA - USA

Të gjitha lavdërimet më të përzemërta dhe më të sinqerta i takojnë Krijuesit të gjithësisë, Allahut (xh.xh). E lusim Allahun të dërgojë paqen dhe selamet e Tij mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin (a.s.), mbi familjen e tij të pastër dhe të nderuar dhe shokët e tij besnikë.

Të nderuar vëllezër dhe motra besimtarë!

Në këtë hytbe të kësaj dite të shenjtë, të ditës së xhuma, kisha dëshirë të ndaj me ju disa fjalë rreth temës e të qënurit pozitiv dhe efektet, që vijnë nga negativiteti. Kjo temë është e bazuar në disa ajete kuranore, por gjithashtu edhe në hadithe të Pejgamberit (a.s) që janë pjesë esenciale e kësaj teme.

Secili person qoftë besimtar apo jo besimtarë në këtë botë, ose më mirë të themi shumica e njerëzve në këtë botë, synojnë të arrijnë gradën e paqes shpirtërore, sikundër shumë njerëz, fatkeqësisht nga sfida të ndryshme me të cilat përballen, nuk arrijnë deri në atë gradë shpirtërore, nuk arrijnë të jenë pozitiv në vetveten e tyre dhe në rrethin ku gjinden.

Shpeshherë edhe besimtarët myslimanë fatkeqësisht nuk i kanë parasysh ajetet kuranore që flasin për paqen, ose megjithëse shpeshherë qoftë prej ajeteve kuranore ose duave, të cilat i bëjnë në pesë kohët e namazit gjatë ditës, harrojnë se çfarë janë duke thënë. Fatkeqësisht, anojnë nga aspekti negativ.

Çfarë kuptojmë këtu, kur themi paqe shpirtërore! Nëse do ta fillojmë me ajetin të cilin unë e përmenda, në pjesën e hytbes në gjuhën arabe, i cili është në suren “Merjem”, Allahu i Madhëruar thotë: Për Jahjanë (a.s.) që të ketë paqe ditën kur ka lindur dhe ditën kur do të vdesë, dhe të ketë paqe ditën kur do të ringjallet edhe një herë, pra ditën e gjykimit. Kurani Famëllartë i konsideron

POZITIVITETI SJELL PAQE SHPIRTËRORE

si pjesë shumë të rëndësishme këto tre pjesë kohore. E cila është lindja njeriut, vdekja dhe ringjallja. Pra çdo etapë e jetës së njeriut, qoftë në këtë botë ose në jetën tjetër ka lidhje me të qënurit në paqe. Por gjithashtu edhe për Hazreti Isanë (a.s), Allahu (xh.sh) në Kuranin Famëllartë përmend duanë në të cilën ai vetë ka bërë.

“Dhe gjithashtu paqja qoftë mbi mu në ditën kur unë kam lindur, në ditën kur unë do të vdes dhe në ditën kur unë do të ringjallet” - edhe një herë para Allahut në ditën e gjykimit. Pra e shikojmë se Pejgamberët e Allahut e kanë përmendur këtë dhe e kanë konsideruar në aspektin shpirtëror të qënurit në shkallen e paqes, harmonisë me Islamin, harmonisë me veten tënde, harmonisë me njerëzit të cilët keni përreth.

Nëse do të vërejmë pak rreth ibadeteve tona, do të shohim se në fund të namazit, fjala e fundit të cilët ne e themi, duke e mbaruar namazin në krahun e djathtë, gjithashtu në krahun e majtë është fjala : “Eselamu alejkum ve Rahmetullah”, në të dyja anët.

Çfarë do të thotë: “Eselamu alejkum ve rahmetullah” në anën e djathtë? Do të thotë paqe; ti si individ i garanton të gjithëve atyre që ke në anën e djathtë paqe. Ti nuk mundesh që pasi ngrihesh dhe del nga dyert e xhamisë me fol fjalë të pista, të ofendosh dikë, t’ia marrësh të drejtën ose hakun dikujt.

Pse? Sepse ti je besimtar, ti je i drejtë. Ti nuk je zullumqar, ti nuk i hyn në hak dikujt tjetër, por ofron paqe. Zoti ty të mëson se si me qenë njeri paqësor dhe të bën ty, që përmes gjuhës tënde ta përmendësh këtë fakt, jo vetëm thjesht me gjuhë por duhet të jetë pjesë e zemrës tënde, sepse namazin nuk e bënë vetëm me gjuhë, por edhe me zemër, nga zemra e çdo individ, pra fjalët duhet të dalin edhe nga zemra dhe jo vetëm nga goja.

Prandaj, kur thua “Eselamu alejkum ve rahmetullah” i garanton secilit person që është në anën e djathtë tënde paqe, pra unë nuk do të merrem me thashetheme ndaj teje, unë nuk do të shpifi ndaj teje, unë nuk do të përgoj ty, nuk do të përgënjeshtroj ty, nuk do të vijë asnjë dëm nga unë, por e vetmja gjë që do të vijë nga unë është paqe. Të njëjtën gjë e bën edhe në anën e majtë “Eselamu alejkum ve rahmetullah”. Të dy pozicioneve, të krahut të djathtë dhe

të krahut të majtë, ti i ke garantuar paqe gjithë botës.

Por jo vetëm kaq, në momentin kur ti mbaron namazin, është e këshilluar të bëhen disa nga lutjet e Pejgamberit tonë, Muhammedit (a.s), që shumë nga ne fatkeqësisht i kemi harru dhe shpejtë dalim nga xhamia kur imami jep selam, sikur kemi një emergjencë jashtë xhamisë dhe largohemi shumë shpejt nga xhamia pa bërë dhikrin, pa bërë lutjet të cilat janë të gjitha synete të Pejgamberit (a.s).

O Zot im, Ti je Paqja dhe prej Teje vjen paqja, i lavdëruar oofsh, o i Lartmadhëruari Bujar!), do të thotë se je duke i thënë Allahut që; Unë mbështetem tek ti për me arrit nivelin e paqes shpirtërore, mbështetem tek ti që të jem një individ, i cili prodhon paqe me veten dhe për njerëzit e tjerë.

Një ndër të parat është “Allahume entes-selamu ve minkes-selam, tebarekte ja dhel-xhelali vel ikram” - (O Zot im, Ti je Paqja dhe prej Teje vjen paqja, i lavdëruar qofsh, o i Lartmadhëruari Bujar!), do të thotë se je duke i thënë Allahut që unë mbështetem tek Ti për të arritur nivelin e paqes shpirtërore, mbështetem tek Ti që të jem një individ, i cili prodhon paqe me veten dhe për njerëzit e tjerë.

Përse shumë nga ne i neglizhojmë këto mësimet?!

Pse? Se kujtojmë se duhet të jemi vulgarë ose siç e thonë disa duhet të jemi trima, trima duke përgjuar njerëz, trima duke e ulur një person tjetër, trima duke ia marrë të drejtën një tjetri.

Kjo nuk është trimëri. Kjo nuk ka lidhje me trimërinë, kjo ka lidhje me zullumin dhe këto janë vepra të personit, i cili quhet zullumqar. Nuk është zullumqar vetëm ai person, i cili godet tjetrin, por edhe ai person i cili ia merr të drejtën tjetrit. Po ashtu përgjuar dhe përgënjeshtuesi hynë në kategorinë

e zullumqarit.

Hazreti Muhammedi (a.s.) në një hadith të tij thotë: “Zullumi (padrejtësia) do të jetë errësirë në ditën e gjykimit!”.

Ne në kontekstin në të cilin jetojmë, në këtë vend të dashur dhe në këtë vend të bekuar, ashtu si njerëzit anë e kënd botës kanë dëshirë që të arrijnë aspiratat përmes qetësisë shpirtërore, të jetojnë me qetësi shpirtërore për veten e tyre dhe për njerëzit, të cilët i rrethojnë.

Mirëpo, kemi disa pengesa të cilat nuk na lejojnë, të cilat mund të jenë gjithandej në shumë vende të tjera të botës.

Në këtë kuadër, dy gjëra shumë esenciale desha të citoj:

E para, paragjykimi dhe e dyta përtacia. Negativiteti i cili vjen prej paragjykimit dhe përtacisë, pra njëra sjellë tjetrën. Shpeshherë për ne të cilët vijmë nga jashtë dhe ulemi me njerëzit tonë, farefisn, shokët, dashamirët, etj. Çuditëmi me faktin se si njerëzit kanë kohë aq shumë që të ulen dhe të ankohen. Ndër bisedat e para dhe më të zgjatura të cilat kemi të bëjmë janë bisedat e ankesës, ankim nga aspekti financiar, ankim nga aspekti shoqëror, ankesë nga aspekti familjarë, ankesë nga aspekti shëndetësorë, ankesë nga kjo e nga ajo...

Sipas disa statistikave të nxjerra nga Universiteti Standford në Amerikë, kanë arritur në përfundim, se një person i cili e dëgjon një person tjetër duke folur për 30 minuta rreth ankesave, në tru është një qelizë, e cila aktivizohet dhe njeriu sikur edhe të mos mendoj shumë e as të mos jetë pjesëmarrës nga ankesa e personit të cilin e ka përballë, arrin që të stresohet në mënyrë automatike. Sa nga ne ankohen 30 minuta? Jo në pozicionin e dëgjuesit, i cila është duke dëgjuar bisedën, që është më keq. Por nëse këtë e bën në mënyrë të përditshme dhe të vazhdueshme, atëherë personi vetë automatikisht konsiderohet si person i depresum ose në stres.

P.sh, thonë se një gotë uji të mbushur në gjysmë, disa e shohin realisht si gjysmë të mbushur, e disa e shohin si bosh, m’varet se si e sheh ti atë gotë me ujë. Pra besimtari në aspektin fetar dhe shoqëror e konsideron jetën, të cilën ja ka dhënë Allahu i Madhëruar, si dhuratë nga Krijuesi. Gëzohet, lumturohet për familjen që i ka dhënë, për bereqetin qoftë shumë ose pak, për shëndetin që i ka dhënë, për fëmijët, për bashkëshortin ose bashkëshorten, për prindërit etj, etj.

Në suren “Ibrahim” Allahu (xh.

Sipas disa statistikave të nxjerra nga Universiteti Standford në Amerikë, kanë arritur në përfundim, se një person i cili e dëgjon një person tjetër duke folur për 30 minuta rreth ankesave, në tru është një qelizë, e cila aktivizohet dhe njeriu sikur edhe të mos mendoj shumë e as të mos jetë pjesëmarrës nga ankesa e personit të cilin e ka përballë, arrin që të stresohet në mënyrë automatike.

xh.) thotë: “Nëse ju do të filloni duke menduar ose duke i numëruar mirësitë të cilat ju ka dhënë Zoti, asnjëherë nuk do të arrini të bëni një që të tillë”. Kjo është në dorën tonë se si i shohim njerëzit përreth, si i shohim alternativat të cilat i kemi në jetën tonë, si i shohim situatat me të cilat përballemi.

Pejgamberi (a.s) në një hadith të tij urdhëron dhe thotë: “Që sikur edhe një gjemb ta shpojë besimtarin, ai ose ajo, nga ajo dhimbje e vogël fiton”. Pse? Sepse besimtari duron, me durim merr sevape nga i madhi Zot, pra është në rritje të sevapeve, është në pozitivitet. Nëse i kanoset diçka e keqe, besimtari bën durim ose e falënderon Zotin kur Allahu (xh.xh) e begaton atë individ. Ne sot e kësaj dite kur përballemi me sfida të ndryshme në jetën tonë nga aspekti financiar, familjarë apo nga aspekti shëndetësor, të mos fillojmë menjëherë duke u ankuar.

Hazreti Jakupi (a.s.) ishte një shembull nga kjo dhe ka thënë: “Unë i ankohem vetëm Allahut për hidhërimin dhe pikëllimin tim”. Hz. Jakupi kishte humbur djalin e tij, Jusufin dhe e dinte që ishte lojë e djemve të tjerë. Më vonë humbi dhe djalin e fundit, Benjaminin, dhe kur i erdhën djemtë e i thanë ne humbëm edhe vëllai tjetër. Realisht atë e mbajti guvernatori i Egjiptit, i cili ishte Hz. Jusufi dhe vëllezërit nuk e dinin!

Unë, nuk jam duke ju ankuar juve për këtë humbje të dytë, nuk jam duke u ankuar njerëzve të tjerë që të më sjellin djalin urgjentisht, nuk jam duke u mbështetur tek ju aspak. Por i mbështetem Allahut (xh.xh.) edhe ne nuk duhet t’i ankohemi njëri-tjetrit ashtu siç bëjmë dita ditës. Pra, në fillim të kapemi pas litarit të Allahut (xh.sh).

Pse? Ti që më ankohesh mua, sa kam unë mundësi të të ndihmoj ty?! Nëse i ankohesh dikujt tjetër, sa ka mundësi që të ndihmojë ty. Në krahasim me të gjitha mundësitë që t’i jep Zoti, Ai është furnizues, Ai ndihmon secilin person që ka nevojë. Nëse të duket se nuk është duke të ndihmuar dhe ti beson tek Ai, ta dish se ai është duke të pastruar nga gjynahet ose është duke të forcuar ose është duke të shtuar sevapet e mëdha.

Pejgamberët Zotit e kanë ditur këtë, prandaj dhe ne urdhërohemi si besimtarë të jemi shembuj, të jemi model për njerëzit e tjerë, të cilët i kemi rreth e rrotull duke i tregu se këto janë vlerat fetare, këto janë vlerat e islamit tonë, i cili na thërret në paqen individuale dhe në paqen kolektive të mjedisit ku jetojmë. Të mos bëhemi si njerëzit e tjerë, që vetëm ankohen e ankohen e i shtojnë vetes atë negativitet, por gjithashtu i shtojnë edhe njerëzve tjerë negativitet dhe në fund ky negativitet ose ankesat e vazhdueshme, që i bën njeriu tek njerëzit e tjerë sjellin përtacinë dhe si pasojë e kësaj shohim shoqërinë e kësaj në të cilën jetojmë duke mos u emancipuar, duke mos pasur progres, por ‘duke ndejë vend numëro’ siç i thotë populli. Sepse kur njeriu ka gjithmonë vetëm ankesa nuk mund të jetë produktiv dhe shpeshherë mbesim në trajtën e të qënurit pasiv dhe jo produktiv.


Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë, që unë të bëj një hap përpara, ta ndryshoj atë, pikërisht siç thotë Pejgamberi (s.a.s.): “Nëse besimtari sheh diçka gabim, e ndryshon atë me dorën e tij. Nëse nuk mundet me dorën e tij, e ndryshon me gojën e tij. Nëse nuk mundet me gojën e tij, e ndryshon me zemrën e tij”. Pra, Pejgamberi (s.a.s.) na thërret të bëhemi proaktiv, produktiv dhe jo në të qenurit e të kundërtës.

E lusim Allahun (xh.sh) që të na bëjë nga ata njerëz, të cilët janë në paqe me veten e tyre, me familjet e tyre, me mjedisin ku jetojnë. Dhe i lutemi Allahut (xh.sh) të na japë nga ajo e cila është më e mira për ne, nga të cilën ne nuk e dimë, por Ai e di dhe nëse vendosë që të na sprovojë me ndonjë fatkeqësi ose me ndonjë vështirësi, inshallah i kapërcejmë. E lusim Allahun që të na bëjnë prej besimtarëve durimtarë. Dhe në raste kur ato gëzohen me dhuratën nga i Madhi Zot, me lumturi të ndryshme nga i Madhi Zot të bëhen falënderues të Allahut (xh.xh.).

Hytbeja e xhumasë në xhaminë

“Ebu Bekër”, më 27 maj 2022

Diktoi tekstin: Sidi të Hafzi



Xhahid Bushati, shkrimtar

Profesor Faik Lulin, metodistin e Gjuhës shqipe dhe didaktin e shquar të Letërsisë e njoha për së afërmi, në shtator të vitit 2003; kur u bëmë kolegë në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”.

Gjatë bisedave të shumta, pashë se tek ai njeri kishin zënë vend e lëshuar rrënjë: qytetaria shkodrane, zemërbardhësia, urtësia e zotësia në rrëfimin dhe shpjegimin e një ore mësimi. Në sytë e mi ai mbetet një model për t’u ndjekur. Gjithashtu, në sytë e mi, me këshillat që më dha, ai mbetet si një prind i dytë.

Gjatë shfletimit të dosjeve të mija personale gjeta dhe një shkrim kushtuar jetës dhe veprimtarisë së babait tim, Hysni Bushati, e, që kishte për autor Profesor Faik Lulin. Gjetja e këtij shkrimi të vyer, u dha jetë edhe shumë kujtimeve...

FAIK LULI

PROFESOR HYSNIU...

Në kujtim të Profesorit të nderuar të Medresës së përgjithshme, Hysni Bushatit

- KUDO LA KUJTIME TË BUKURA, KUDO KRIJOI MIQ E DASHAMIRË, KUDO SIGUROI FALËNDERIME, MIRËNJOHJE E URIME...-

1.

Hysni Bushati është një figurë, që nuk i bie asnjëherë pluhuri i harresës. të huaj për të janë zbehtësia e indiferenca. Ëndrra e tij – Besimi Islam. E gjithë jeta e tij aty mbeti e skalitur... Këtë traditë si një gurrë të pastër e të pashterrshme ia ushquu i ati, Haliti, një klerik mysliman me zë në qytetin e Shkodrës, i përmendur veçanërisht në fushën e drejtësisë Islame. E ushquu... dhe për Hysniun figura e të atit “Lita begut” siç i thoshin, mbeti një idhull, një mit, ndoshta më shumë...

PROFESOR FAIK LULI, METODIST I GJUHËS SHQIPE DHE DIDAKT I SHQUAR I LETËRSISË

2.

Hysni Bushati lindi me 31.12.1909 në qytetin e Shkodrës. Vendlindjen, dhe në veçanti figurën e nënës, Mejremen (Memen) nuk do t’i harrojë kurrë, edhe pse vazhdoi gjatë, në fillim nxënës dhe më pas Mësues në Medrezenë e Përgjithshme të Tiranës. Për tetë vjet radhazi portreti i tij do të mbart një formim shkencor, fetar, pedagogjik e atdhetar. Jeta e tij do t’u rezervojë një nderim të veçantë personaliteteve të kohës si Hafiz Ismet Dibra, Mësuesve me autoritet kombëtar, si: Haxhi Dashi, Sheh Qazim Hoxha, Jonuz Buliqi, Haki Sharofi, etj. (Të mos harrojmë se kjo shkollë me emër grumbulloi nxënës të talentuar, si: Vexhi Demiraj, Sherif Putra, Sadik Bega, Vexhi Buharaja, Shaban Demiraj, Vehbi Ismaili, Sali Ferhati, Ismail Muçej, etj., që do të bëheshin kuadro të shquara e të nderuara në fushën arsimore, fetare, kulturore, shkencore, publistike. Këtij brezi i përkiste edhe Hysni Bushati).

3.

Në Medreze Hysni Bushati u pajis me një kulturë të gjerë gjuhësore, mësoi arabishten, persishten, anglishten e më vonë dhe italishten. Për efekte studimi shfrytëzonte edhe turqishten e frëngjishten. Krahas këtyre gjuhëve fitoi edhe një kulturë letrare, historike e filozofike-fetare islame me ngjyra të theksuara shqiptare.

Hysniu qe ndër të diplomuarit e parë në vitin shkollor 1931 – 1932. Kuptimplotë për formimin e përgjithshëm të këtyre studentëve është përshëndetja vlerësuese e gjithanshme dhe frymëzuese që Ministri i Arsimit të kohës Hil Mos (poet, publicist, patriot e demokrat) që bëri me rastin e shpërndarjes së diplomave, duke thënë ndër të tjera: “... Sot, ju Maturantët e parë të këtij Instituti jeni edukue prej një trupi profesorësh shqiptarë të udhëhequn prej drejtorit patriot të mirënjohut, jeni pajisë me ndjenja kombëtare e morale... (Revista “Zani i Naltë”, viti 1932, f. 472 – 473).

Për rezultatet e shkëlqyera, Hysniu meritoi një vlerësim të rrallë, u emërua Mësues i medrezës së Përgjithshme. Menjëherë pas diplomimit, nga student në koleg me Profesorët e vet të nderuar. Besimin e kryesisë së Komunitetit

Mysliman dhe të drejtorisë së shkollës e justifikoi me një veprimtari të madhe e të ndërgjegjshme, sepse punoi me përkushtim e ndjenjë të lartë përgjegjësie, duke qenë krahas mësuesit nxënës i përhershëm, mik i pandarë i librave dhe i shtypit shqiptar e të huaj.

Dy kujtime të ish-nxënësve, për të shprehur e përgjithësuar përshtypjet e mbresat e dhjetra e qindra nxënësve që ai mësoi e edukoi në këtë shkollë. Safet Hoxha, pedagog i gjuhës shqipe në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, kujton: “Profesor Hysni Bushatin e njoha jo si kolegu-kolegun ose shoku-shokun, por si nxënësi mësuesin e vet, ndaj të cilit ruaj edhe sot ndjenja të mirënjohjes e të nderimit. Unë si dhe shumë shokë të mi bashkënxënës që patëm fatin ta kemi pasur mësues Profesor Hysni Bushatin, arritëm të kuptonim me kohë se ai i përkiste atij brezi të mësuesve atdhetarë që punuan pa u lodhur, duke dhënë ndihmesë me vlerë në krijimin dhe konsolidimin shkencor dhe pedagogjik – metodik të shkollës shqiptare. Profesorit të ri iu besua dhënia e lëndëve historike, ku një vend të veçantë zinte sidomos Historia e Shqipërisë, për të cilën ai kishte një pasion të veçantë. Edhe sot, kur i kemi mbushur të 70-tat, vazhdojmë t’i ruajmë të freskëta kujtimet për mënyrën se si e shpjegonte ai këtë lëndë, duke himnizuar e duke e shoqëruar me kallëzime popullore, me këngë trimërie e legjendare e materiale të tjera, me të cilat edukonte tek ne dashurinë për Atdheun, popullin, kulturën e tij... etj. Porfesor Hysni me qetësinë dhe elokuencën që e karakterizonte në të folur shpjegonte bindshëm e me argumente, me durim e me kompetencë, çështjet lidhur me formimin e brezit të ri shqiptar, me raportet midis kombëtares e fetares... etj. Mbit ë gjitha ajo që n aka mbetur si mbresë e pashlyeshme në kujtesë ishte kërkesa që ai shtronte për emancipimin e rinisë Islame shqiptare, para së cilës qëndronin detyra për forcimin e unitetit kombëtar shqiptar, për të dalë te koncepti “Atdhe e Fe”, që ka pasur dhe vazhdon të ketë vlerë universal në “Historinë kombëtare shqiptare”.

Profesor Hysni u kujtua edhe nga

një tjetër ish-nxënës i tij, personalitet i shquar i kulturës islame në diasporë, Imam Vehbi Ismaili, kryetar i Komunitetit Mysliman të shqiptarëve të Amerikës e të Kanadasë. Me rastin e një vizite të tij në atdhe, në një intervistë të dhënë ndër të tjera ai kujtoi me mallëngjim e krenari jetën e tij si student i Medrezës së Përgjithshme të Tiranës deri në vitin 1937, duke përmendur ndër mësuesit më të dashur, të nderuar e të vlerësuar edhe Profesor Hysni Bushatin.

Më vonë Hysni punoi si mësues në Medrezenë e Shkodrës në vitet 1944 – 1947, derisa u mbyll në kuadrin e luftës kundër institucioneve fetare. Në këtë detyrë ai solli përvojën e pasur të Medrezës së Përgjithshme të Tiranës, ishte ndër mësuesit më aktivë e më në zë të lëndëve të kulturës së përgjithshme. Ai u bë mbështetja kryesore e drejtorisë në shkolla për anën organizative dhe pedagogjike, për hartimin e orarit, për realizimin e lëndëve fetare e të kulturës së përgjithshme në kushtet e specifikës së shkollës për harmonizimin e veprimtarisë së procesit mësimor-edukativ me atë jashtë klase e shkolle, për organizimin e jetës në konvikt, për marrëdhëniet me prindërit e për bashkëpunimin me institucionet fetare e bamirëse. Ndër kolegë, nxënës e prindër me punën e tij e sjelljen, me kulturën e edukatën e tij, me bashkëveprimin me ta, fitoi një nderim të veçantë shkollor e qytetar.

4.

Gjatë periudhës 1932 – 1947, në Tiranë e në Shkodër krahas angazhimit kryesor në dy medreze ka punuar edhe si mësues besimi ndër disa shkolla shtetërore, ku zhvillonte mësimet historike-fetare, në bazë të një programi të miratuar nga Komuniteti Mysliman dhe Ministria e Arsimit. Në këto mësimet zhvillonte tema me karakter historiko-fetar që lidheshin me bazat filozofike të Islamit dhe me normat morale e shoqërore të fesë islame, në përputhje me mjedisin shqiptar, me gjendjen e kohës, me edukimin shpirtëror dhe atdhetar të fëmijëve. Këto mësimet shpesh në shkollë e jashtë saj shndërroheshin

në biseda të gjalla, interesante e të dobishme jo vetëm me nxënësit, por edhe me prindërit e me mësuesit e lëndëve të tjera. Hysni me qetësi, me takt, me arsytim, fakte e shembuj të qartë e të kuptueshëm shpjegonte, sqaronte, bindte e realizonte natyrshëm përmbajtjen e tekstit, u jepte përgjigje pyetjeve e dyshimeve dhe arrinte të ndikonte në formimin e besimtarëve më të ndërgjegjshëm në fëmijët, të rinjtë e të moshuarit.



Një ish-nxënës, më vonë mësues, sot pensionist shpreh, për Hysniun që e ka pasur mësues besimi në shkollën e Parrucës në Shkodër, fjalët më të larta vlerësuese e më të thella mirënjohëse për formimin, karakterin, marrëdhëniet me fëmijët e për metodikën e paraqitjes, përforcimit, të kontrollit e të zbatimit praktik të normave fillestare moralofetare. Ndonëse në kushte jot ë favorshme, ai e kryente detyrën me bindje e pa frikë. Ish-nxënësi pohon: “Çdo pjesë Ku’anore, çdo thënie Profetike, çdo lutje fetare na e përkthente në shqip, na e zbrëthente qartë, na e lidhte me jetën e kërkonte që të zbatohet nga ana jonë në praktikën e përditshme, të bëhej pjesë e sjelljeve e veprimeve tona moralofetare. Ai me mjeshtri na ushqente vazhdimisht me normat e dhura që na u bënë udhërrëfyese në mënyrë të dukshme e të padukshme, gjatë gjithë jetës sonë, me gjithë vështirësitë, pengesat, shqetësimet e ndalesat fetare që kaluam në ndërgjegjen tonë për disa dekada. Ata mësimet fetare i kemi gjithmonë në ndërgjegjen tonë, na kanë shoqëruar e na kanë ndihmuar për edukimin shpirtëror”.

5.

Kujtimet janë të shumta për figurën e ndritur të profesor Hysniut. Gjithsesi ato lënë diçka mangut pa thënë, pa e shprehur në mënyrë të plotë. Sidoqoftë, ne nuk duhet të harrojmë atë burrë me trup mesatar, , që gëzonte një shëndet të plotë, që kish një ecje të ngadaltë dhe një zë të javashtë, por edhe shpesh kumbues. Mbase më mirë nga të gjithë, në mes shumë të tjerëve e dinë nxënësit e shkollës së Perashit, e të fundit vocërrakët e shkollës 8-vjeçare “Perlat Rexhepi”... Gjithashtu do të kujtojmë humorin e tij, të qeshurën, veshjen e tij “që gjithmonë i këndonte tesha”... e deri tek ajo kaligrafi e bukur e shkrimit, që ishte për t’u pasur zili. (Dua të theksoj që zemra e tij pikoi dashuri mbi vargjet kuptimplotë e plot finesë e frymëzim të poezisë-këngë me titull: “Qbabja e Madhnueshme”, autor i së cilës ishte vetë Hysni).

E pushuan disa herë nga puna. Jo vetëm, por nuk u mjaftuan, e nxorën një vit para në pension. Përsëri nuk u mërzi, qëndroi i papërkulur në misionin e tij si mësues, besimtar e atdhetar.

Dëshironte t’i shihte të ngritura institucionet fetare e xhamitë, por nuk i pa... Në përfytyrimin e tij ato ishin të ngritura. Në zemrën e tij BESIMI tek ISLAMI ishte i pushuar...

Një ditë gushti (02.08.1966) syri i Hysniut u kthye në lot të përhershëm, zemra iu bë ëndërr e pashpresë nga vdekja e papritur e të birit, Haliti 27 vjeçar, të cilin e donte më shumë se shpirti. Duke mos duruar këtë dhimbje të madhe, Hysni vdiq, me 13.10.1966, tre muaj pas vdekjes së djalit, duke lënë pas kujtime të bukura, të dritshme dhe një emër të nderuar...

Shënim: Në foton e paraqitur, babai im Hysni është në rreshtin e dytë, i fundit djathtas dhe përkon me një moment të rëndësishëm të jetës së tij, dhe ashtu siç ka shënuar me shkrimin e tij: “Kujtim i provimit dhe i Komisionit provues të maturitetit të Medrezës së Përgjithshme. Tiranë, me 7 – X – 1932.”

Shkodër, më 25.04.2022
(Xhahid Bushati)



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Islami na mëson se besimi ndahet në dy pjesë: Gjysma e tij është falënderimi dhe gjysma tjetër është durimi. Njeriut ose i dhurohen të mira, për të cilat duhet të shprehë mirënjohje e falënderim ose goditet nga sprovat e fatkeqësi, të cilat duhet t'i durojë.

1. Të jemi falënderues ndaj Zotit për të mirat që na ka dhuruar.

Dijetarët muslimanë kanë thënë se falënderimi realizohet dhe ndërtohet mbi tri shtylla kryesore, e ato janë:

I. Bindja e paluhatshme se mirësitë janë prej Allahut; Allahu është Ai që të begatoi më shëndet, me të mirë, me pasuri, me qetësi etj.

II. Shfrytëzimi i këtyre mirësive aty ku kënaqet Allahu. Pra, të gjitha mirësitë me të cilat të begatoi Allahu, ti duhet t'i shfrytëzosh vetëm aty ku kënaqet Dhuruesi (Allahu) i këtyre mirësive. Allahu të furnizoi me shëndet, shfrytëzoje shëndetin në adhurim ndaj Tij. Allahu të furnizoi me pasuri, jepe zekatin dhe dhuroju lëmoshë atyre që kanë nevojë për të.

III. Njih mirësitë e Allahut dhe tregohu mirënjohës ndaj tyre fshehtas (me zemër) dhe haptas (falëndero me gjuhë, vepër). Gjuha e njeriut shpreh atë që ai ka në zemër, kur zemra të mbushet me mirënjohje ndaj Allahut, atëherë gjuha e përmend dhe e lavdëron Atë pa pushim. Allahu (xh.sh) thotë: "Të mirat që t'i ka dhënë Zoti yt, tregoj!"¹

2. Të jemi të kënaqur me caktimin e Allahut. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kënaqu me atë që ta ka caktuar Allahu, do të jesh njeri më i pasur."² Njeriu më i pasur nuk është ai që ka shumë pasuri por i pasur është ai që është i kënaqur me atë që ka.

1. Kurani, Ed-Duha: 11.
2. Transmetuar nga Tirmidhiu.

QËNDRIMI I BESIMTARIT NDAJ BEGATIVE TË ALLAHUT

3. Begatitë janë të ndryshme, por begatia më e madhe e Zotit ndaj teje është që të ka zgjedhur mes të tjerëve dhe të ka bërë besimtar. Besimi është një prej mirësive më të mëdha që Zoti i ka dhuruar njeriut. Këtë mirësi besimtari duhet ta ndiejë në zemër; të mendojë se si e zgjodhi Zoti mes shumë njerëzve për të qenë besimtar.

A nuk është begati e madhe falja e namazit të sabahut në xhami ku shumë të tjerë në atë kohë janë fjetur? Padyshim që po. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Dy rekate (sunset) të sabahut janë më të dobishme sesa e gjithë bota dhe çfarë ka në të."³ Nëse dy rekartet sunset të namazit të sabahut qenkan më të vlefshme sesa e gjithë dynjaja me bukuritë e saj dhe gjithçka ka në të, paramendoni çfarë vlere paska atëherë farzi i namazit të sabahut!? Tregohet se Lukman Hakimi (Lukmani i urtë) e këshilloi djalin e tij: "O djali im, të mos bëhet gjeli më i mirë sesa ti! Gjeli zgjohet për sabah dhe këndon, ndërsa ti nuk zgjohesh e nuk falehsh."

Prandaj duhet të dimë t'i vlerësojmë begatitë. Një nga lutjet që Pejgamberi (a.s) thoshte kur zgjohej prej gjumit është: "Falënderimi i takon Allahut, i Cili më dha shëndet në trup, ma ktheu shpirtin dhe ma mundësoi ta përmend Atë."⁴ Një ditë disa njerëz e pyetën Aliun (r.a): Si u zgjove në sabah o prijësi i besimtarëve? Aliu (r.a) u përgjigj duke thënë: U zgjova me begati të shtuara dhe me falënderim të mangët.

4. Sado që njeriu mundohet ta falënderojë Allahun, ai nuk ia jep dot hakun Atij. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s) thotë: "I dëlirë je Ti, o Zoti im, larg çdo të mete! Ne nuk mund të të lavdërojmë dhe falënderojmë ashtu siç e meriton!"⁵

Hudhejfe (r.a) ka thënë: "Një natë u fala pas Profetit (a.s) (namaz nafle). Ai filloi të lexojë suren El-Bekare. Pasi lexoi 100 ajete, mendova se do të bjerë në ruku, por ai (a.s) vazhdoi të lexonte. Atëherë mendova, se do ta lexonte të gjithë suren. Kur e mbaroi suren, mendova se do të bjerë në ruku, mirëpo ai filloi të lexonte suren (Ali-Imran dhe

3. Transmetuar nga Muslimi.
4. Transmetuar nga Tirmidhiu.
5. Transmetuar nga Muslimi.

më pas suren En-Nisa)⁶.

Leximi i tij ishte normal dhe jo i shpejtë. Kur lexonte një ajet lavdërimi, e lavdëronte Allahun, kur lexonte një ajet lutjeje, lutej dhe kur lexonte një ajet kërcërimi, kërkonte mbrojtje tek Allahu. Më pas ra në ruku dhe tha: "Subhane rabbijel adhim". Ai e zgjati rukunë afërsisht aq kohë sa kishte qëndruar në këmbë. Më pas tha: "Semiallahu limen hamideh", u ngrit nga rukuja dhe qëndroi në këmbë afërsisht aq sa qëndroi në ruku. Më pas ra në sexhde dhe tha: "Subhane rabbijel a'ala". Ai (a.s) e zgjati sexhden afërsisht sa qëndrimi në këmbë."⁷

Pejgamberi (a.s) ishte njeriu më falënderues ndaj Zotit. Ai e adhuronte Allahun aq shumë me namaz, sa që i ënjteshin këmbët. Bashkëshortja e tij, Aishja (r.anha) i tha: "O i Dërguar i Allahut, pse e mundon veten kaq shumë, ndërkohë që Zoti t'i ka falur të gjitha gjynahet?! – Profeti (a.s) ia ktheu: - O Aishe, e si të mos jem rob falënderues (për Allahun)?!"⁸

Një ditë Aliu (r.a) i tha një personi: "Begatia vazhdon me falënderim, falënderimi i shton të mirat. Këto dy gjëra shkojnë paralel. Nuk ndërpritet shtimi i begative nga Allahu, deri sa nuk ndërpritet falënderimi nga njeriu."⁹

5. Begatitë që Allahu na i ka dhënë t'i ndajmë me të tjerët. Nëse Allahu të ka begatuar me dituri, mësojua atë të tjerëve, nëse të ka begatuar me pasuri ndaje atë me të tjerët. Kur Allahu (xh. sh) e ka begatuar Pejgamberin (a.s) me ndonjë begati, ai e ka ndarë atë me të tjerët. Mësohu edhe ti, që begatitë t'i ndash me të tjerët, se Allahu t'i shton ato edhe më shumë. Të mos mendojmë sikur kurejshit e Mekës kur u thuhej: Jepni nga ajo, me të cilën Allahu ju begatoi, ata thonin: "Pse, ne do t'i ushqejmë ata, të cilët, nëse do të donte Allahu, do t'i kishte ushqyer?"¹⁰

6. Sureja El-Bekare, Ali-Imran dhe En-Nisa janë tre suret më të gjata të Kuranit. Surja e El-Bekare ka 286-të ajete, Ali-Imran ka 200 ajete dhe En-Nisa ka 176 ajete.

7. Transmetuar nga Muslimi.
8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
9. Transmetuar nga Ibn Ebi'd-Dunja dhe Bejhakiu në Shuabu'l-Iman.
10. Kurani, Jasin: 47.

NJOFTIM PËR HAXHIN 1444/2022

Myftinia Shkodër ju lajmëron,
se në bazë të njoftimit zyrtar të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,
regjistrimet për Haxhin e këtij viti vazhdojnë derim më datën, 12 qershor 2022,
sipas kushteve të mëposhtme:

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë njofton të gjithë të interesuarit
se tarifa e haxhit për këtë vit është 4900 Euro.

Regjistrimet kanë filluar dhe do të vazhdojnë deri më 12 Qershor 2022.

Këtë vit do të mund të kryejnë haxhin të gjithë besimtarët,
të cilët fillimisht duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

1. Mosha maksimale e lejuar është 65 vjeç.
2. Të interesuarit duhet të jenë të vaksinuar (me dy doza) kundër COVID 19.
3. Testi PCR negativ, i bërë brenda 72 orëve para hyrjes në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Të gjitha informacionet e tjera që përfshijn paketa e haxhit mund ti gjeni në posterat e bashkëngjitur.

Regjistrohuni pranë Myftinisë Shkodër

Haxhi 2022

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
ORGANIZON HAXHI 2022 4900 €

Në paketën e Haxhit përfshihen:

- Transporti ajror vllasë-ardhë.
- Transporti me autobus në Mekë dhe Madinë
- Akumodimi në hotele
- Ushqimi: Mëngjesi, dreka dhe darka
- Kuqerimi, uji i zemzemi, numera telefonik
- Shërbimi nga ledoçit dhe mekësi përgjatë rrugës

Dokumentet e nevojshme:

- Pasaporta e vlefshme jo më pak se 1 vit. Ndërsa personat që nuk kanë nënshkrimin shqiptar, duhet të paraqesin letër e qëndrimit, me afat vlefshëm jo më pak se 6 muaj
- Fotografi pasaportë
- Certifikatë që vërteton lidhjen e gjakut me shqiptarët dhe femrave që janë nën moshën 45-vjeçare
- Vakansa kundër mospajës, me afat jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se tre vjet

REGJISTROHUNI PRANË KMSH-SË OSE PRANË MYFTINISË
SË QYTETIT TUAJ DERI MË 12 QERSHOR 2022

0673222223

Haxhi 2022

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
ORGANIZON HAXHI 2022 4900 €

"Kryeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut." (Bekare, 176)

Haxhi ka plotësi vllasë dhe shqiptare. Me kryesimin e haxhit, haxhi mundëson që ndihet i falen mekës dhe zemra e tij të pashtriket prej gjuhës. Profeti i ndërruar: paqja e Zotit qëllë rrejtë, në mënyrë të shpejtë: "Kushdo që për hir të Allahut kryen haxhin, u shpëton qelbës dhe shpirtit të pashtriket dhe u largohet mekësive, këmbës i pastër dhe gjuhës së tij i pashtriket nga rrejtë e tij."

Personi që dëshiron të kryej haxhin duhet të plotësojë këto kushte:

- Mosha maksimale e lejuar është 65 vjeç. Data e fundit e pranimit është 30.06.2022
- Të interesuarit duhet të jenë të vaksinuar (me dy doza) kundër COVID 19, vlefshëmësi e doza të dytë jo më shumë se 6 muaj
- Testi PCR negativ, i bërë brenda 72 orëve para hyrjes në Mbretërinë e Arabisë Saudite
- Pasaporta të kësë vlefshëmësi më shumë se 1-vit nga data e shpërndarjes
- Për gratë deri në moshën 45-vjeç duhet të kenë shqiptarë (bashkëshort, babai, vllaz, etj.)

REGJISTROHUNI PRANË KMSH-SË OSE PRANË MYFTINISË
SË QYTETIT TUAJ DERI MË 12 QERSHOR 2022

0673222223

NË TË GJITHA XHAMITË E SHKODRËS U FESTUA MË MADHËSHTI FITËR BAJRAMI



XHAMIA PARRUCË



XHAMIA PARRUCË



XHAMIA BARBULLUSH



XHAMIA SHTOJ I RI



XHAMIA SHTOJ I RI

Më 2 maj 2022, mijëra besimtarë myslimanë në të gjitha xhamitë e Shkodrës kryen ritualet e Fitër Bajramit, që është një nga festat më të mëdha të fesë islame.

Ceremonitë më kryesore u mbajtën në xhamitë "Ebu Bekër" dhe Parrucë për të falur namazin Bajramit të Ramazanit.

Në xhaminë e Parrucës Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ka uruar, që në këtë festë të shenjtë besimtarët të manifestojnë bashkim, dashuri dhe falje, sikurse është lutur për mbarë njerëzimin për mirësi e paqe me veten dhe me të gjitha krijesat në tokë.

Në ceremoninë e bajramit që u shoqërua me këndimin e disa ilahive nga dy hafizë turk të ardhur enkas nga Diyaneti i Turqisë për t'u angazhuar gjatë Ramazanit dhe Bajramit, folën dhe dhanë mesazhe të vyera edhe dy imamë t e kësaj xhamie, H. Naim Drijaj dhe H. Durim Kasemi.

Pas faljes së namazit të Fitër Bajramit besimtarët vazhduan festimet në shtëpitë e tyre dhe më të afërmit dhe miqtë e tyre.



XHAMIA E "DY VAJZAVE"



XHAMIA BARDHAJ



XHAMIA BARDHAJ

"TË FESTOJMË SË BASHKU BAJRAMIN" AKTIVITET FESTIV ME FËMIJËT ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT

Ditën e hënë, më 2 maj 2022, pikërisht në ditën e parë të Fitër Bajramit, pas rriteve të bajramit që u zhvilluan në xhamitë e qytetit, Myftinia Shkodër organizoi në sheshin pranë xhamisë së Parrucës panairin "Të festojmë së bashku Bajramin".

Në këtë aktivitet që morën pjesë rreth 300 fëmijë të moshave të ndryshme, kishte në fokus fëmijët dhe tradita e hershme së vizitave derë më derë në ditën e parë të çdo bajrami.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari tha se ky organizim do të kthehet në traditë për të mbajtur gjallë atmosferën festive të kësaj feste madhështore.

Fëmijët që morën pjesë në panair, ku një pjesë tyre ishin edhe nxënës të disa mejtepeve fetare, lexuan pjesë nga Kurani Famëlartë, recituan ilahin të ndryshme dhe dhanë urimet e tyre për festën e madhe të Fitër Bajramit.

Aktiviteti bëri jehonë edhe në mediat audiovizive si dhe në rrjetet sociale!



UZBEKISTANI OSE REPUBLIKA E UZBEKISTANIT

Uzbekistani, ose zyrtarisht Republika e Uzbekistanit, është një shtet në Azinë Qendrore, dhe kufizohet me Kazakistanin në veriperëndim dhe veri, me Kirgistanin në lindje, me Taxhikistanin në juglindje, me Afganistanin në jug, dhe me Turkmenistanin në jugperëndim.

Brenda Uzbekistanit, është edhe një republikë autonome: Karakalpakstan dhe gjendet në pjesën perëndimore të vendit.

Kryeqyteti i Uzbekistanit është Tashkenti. Qytete të tjera të rëndësishme janë Nemengan, Endixhan, Nukus, Buhara dhe Samarkandi.

Uzbekistani ka një sipërfaqe prej 448.978 km², dhe një popullsi prej 34.399.149 banorësh (sipas worldometers.info / Maj, 2022)

Sipas studjuesëve, origjina e fjalës Uzbekistan nuk është e qartë. Një teori thotë se varianti Uz, i fjalës Uğuz, më parë Oğuz, u bashkua me fjalën Bek për të formuar “Uğuz-bek, në Uz-bek”, që do të thotë “udhëheqësi, ose prijësi, i oguzëve”.

GJEOGRAFIA

Territori i Uzbekistanit është një kombinim i veçantë i fushave dhe i terrenit malor. Pjesa më e madhe e territorit të Uzbekistanit është e përbërë nga fushat (rreth katër të pestat e territorit), ku njëra nga më kryesoret është fusha e Turanit. Në lindje dhe verilindje të vendit ndodhen burimet e Tien Shan dhe malet Pamir, ku është edhe pika më e lartë në vend (4643 m). Në pjesën veriore qendrore të territorit të Uzbekistanit ndodhet një nga shkretëtirat më të mëdha në botë: Kyzylkum.

Malet dhe ultësirat zënë rreth 1/5 e territorit të vendit. Lindja e vendit dominohet nga forma të mesme dhe të larta të relievit. Brenda territorit të vendit zbresin shpatet e Tien Shan-it perëndimor, dhe të vargmalit Pamir- Alai.

Lugina më e madhe ndërmallore - lugina Ferghana – ka një gjatësi prej 370 kilometrash, dhe një gjerësi që shkon deri në 190 kilometra. Në tre anët e saj është e rrethuar nga vargmalet dhe hapet vetëm nga perëndimi.

Në kufirin me Afganistanin, gjendet një liman i gjerë i lumit Amu-Darja.

KLIMA

Uzbekistani ka një klimë kontinentale shumë të thatë, me temperatura të larta. Në verë, në pjesën më të madhe të vendit temperatura arrin deri në 44 °C. Kurse në dimër, temperatura zbret deri në -25 dhe -38 °C. Sa i përket temperaturës gjatë verës, në zonat malore me lartësi mbi 3000 m, ajo sillet rreth 23 - 25 °C. Temperatura mesatare në vend, në Korrik, është 32 °C, ndërsa në Janar zbret në -10 °C.



Uzbekistan karakterizohet nga rreshjet e pakëta të shiut (100–200 milimetra). Ai është vendi i gjashtë ekorajoneve tokësore: stepat Alai - Tian Shan perëndimore, pyjet e hapura Gissaro-Alai, gjysmë-shkretëtira Badgiz dhe Karabil, shkretëtira veriore e Azisë Qendrore, pyjet bregore të Azisë Qendrore (përgjatë lumenjve Syr Darja, Amu Darja, Chu dhe Ile), dhe shkretëtira jugore e Azisë Qendrore.

GJUHA

Gjuha Uzbeke është gjuha zyrtare e Republikës së Uzbekistanit, gjuhë e cila është një vazhdim i turqishtes Chagatai, dhe flitet nga afërsisht 35 milionë uzбекë që jetojnë në vende si Afganistani, Kirgistani, Kazakistani, Turkistani Lindor, Taxhikistani, Turkmenistani, Federata Ruse, Arabia Saudite dhe Turqia, si dhe Uzbekistani. Ndikimi i arabishtes dhe persishtes në uzbeqisht, është më i madh se në gjuhët e tjera turke të Azisë Qendrore. Në Uzbekistan, deri

në vitin 1929 u përdor alfabeti arab, pastaj alfabeti latin (1929-1940), dhe alfabeti cirilik (1940-1993). Në fillim të mijëvjeçarit të ri, qeveria rivendosi sistemin e alfabetit latin.

Rajoni autonom Karakalpakstan flet gjuhën Karakalpak (që është një degëzim i largët i gjuhës turke), dhe e ka atë si gjuhë zyrtare, krahas asaj Uzbeke. Gjuha Karakalpak flitet nga rreth gjysmë milioni njerëz.

Rreth një e shtata e popullsisë së Uzbekistanit flet rusisht.

FEJA

Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Uzbekistanit, 96 % e popullsisë janë myslimanë. Shumica e muslimanëve janë sunitë, ndjekës të shkollës Hanefi. Afërsisht 2.2 % e popullsisë janë ortodoksë rusë, dhe pjesa e mbetur (1.8 %) u përkasin komuniteteve të vogla katolike, të krishterë etnikë, koreanë, baptistë, luteranë, hebrej, etj.

EKONOMIA

Ekonomia e Uzbekistanit është në një tranzicion gradual drejt ekonomisë së tregut. Uzbekistani është një prodhues dhe eksportues i madh i pambukut. Me objektet gjigante të prodhimit të energjisë, nga epoka sovjetike, dhe me një pasuri të bollshme të gazit natyror, Uzbekistani është një nga prodhuesit më të mëdhej të energjisë elektrike

në Azinë Qendrore. Sipas një raporti të Institutit Brookings, Uzbekistani ka asete (prona) të mëdha likuide, rritje të lartë ekonomike dhe borxh të ulët publik.

Uzbekistani nxjerr 80 ton ar në vit (dhe zë vendin e shtatë në botë për nga sasia). Depozitat e bakrit në Uzbekistan zënë vendin e dhjetë në botë, dhe depozitat e uranimit, të dymbëdhjetin. Kompania kombëtare uzbeke e gazit, Uzbekneftegas, renditet e 11-ta në botë për prodhimin e gazit natyror. Vendi ka rezerva të konsiderueshme të pashfrytëzuara të naftës dhe gazit, me 194 depozita hidrokarburesh.

Uzbekistani është gjithashtu i njohur për pemishtet dhe vreshtat e tij dhe për rritjen e bagëtive. Pasuria baritore atje vlerësohet në dhjetë milionë dele dhe bagëti.

HISTORI

Njerëzit kanë banuar në atë që është tani Uzbekistani, qysh në Periudhën Paleolitike. Shtetet e mëdha të Bactria, Khavarizm dhe Sogdiana, u shfaqën gjatë mijëvjeçarit të parë, para erës sonë, në rajonin pjellor rreth lumit Amu Darja, rajon i cili shërbeu si qendër e tregtisë dhe shkëmbimit kulturor midis Lindjes dhe Perëndimit, në Rrugën e Mëndafshit.

Pas ardhjes së Islamit në Azinë Qendrore, në shekullin e 8-të të erës sonë, disa rryma të popullsisë erdhën në territorin që tani formojnë tokën e Uzbekistanit. Migrimet kontribuan në diversitetin demografik që karakterizon Uzbekistanin. Ushtritë muslimane arabe erdhën atje pas vitit 711 të e.s. Më vonë, nga shekulli i 13-të, atje mbërritën mongolët, nën udhëheqjen e Xhengiz Khan-it. Në shekujt 15-17, atje erdhën Dzungarët, dhe në shekullin e 18-të erdhën persianët.

Në fund të shekullit të 19-të, vendi u pushtua nga rusët.

Megjithëse izolimi gjeografik i Azisë Qendrore e ngadalësoi përparimin drejt jugut të forcave ruse, Buhara u pushtua në vitin 1868, dhe Khiva në vitin 1873. Të dyja këto khanate u bënë protektorat rus. Një kryengritje në Kokand u shtyp në vitin 1875, dhe khanati u aneksua zyrtarisht vitin e ardhshëm, duke plotësuar kështu pushtimin rus të territorit të Uzbekistanit, dhe rajoni u bë pjesë e provincës ruse të Turkistanit.

Revolucioni rus i vitit 1917, solli destabilitet dhe konflikt në Turkistan. Myslimanët thirrën një kongres kombëtar, në Kokand, dhe krijuan një qeveri autonome nën Mustafa Chokayev, qeveri e cila u likuidua në Shkurt të vitit



TASHKENTI , KRYEQYTETI I UZBEKISTANIT

1918, nga forcat e Ushtrisë së Kuqe, të dërguara nga Tashkenti.

Në vitet 1924–1925, politikanët e drejtuar nga Partia Komuniste Ruse ripërpunuan hartën e Azisë Qendrore, sipas një parimi monoetnik për çdo entitet të madh dhe popullin e tij. Karakalpakstani dhe Uzbekistani u ngritën brenda natës si territore të përcaktuara etnikisht brenda Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike; më 27 Tetor të vitit 1924, u krijua Republika Socialiste Sovjetike e Uzbekistanit. Karakalpakstani u transferua në R.S.S të Uzbekistanit në vitin 1936, megjithëse ruajti statusin autonom.

Lufta e Dytë Botërore (1939–45) solli ndryshime të mëtejshme të theksuara kulturore, pasi autoritetet sovjetike zhvendosën mijëra menaxherë, intelektualë dhe figura kulturore rusë, polakë dhe hebrenj, në qytetet dhe fshatrat e Uzbekistanit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, 1.433.230 njerëz nga Uzbekistani luftuan në Ushtrinë e Kuqe kundër Gjermanisë naziste. Rreth 263.005 ushtarë uzбекë vdiqën në fushat e betejës të Frontit Lindor, dhe 32.670 u zhdukën në aksion.

Më 20 Qershor të vitit 1990, Uzbekistani shpalli sovranitetin e tij shtetëror, dhe Islam Karimov (më parë sekretar i parë i Partisë Komuniste të Uzbekistanit, që nga viti 1989), u zgjodh president i Republikës Socialiste Sovjetike të Uzbekistanit. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, Uzbekistani shpalli pavarësinë e plotë më 31 Gusht të vitit 1991 dhe 1 shtatori u shpall Dita e Pavarësisë Kombëtare.

Islam Karimov u zgjodh president i Uzbekistanit të pavarur.

SI ERDHI ISLAMI NË UZBEKISTAN?

Azinë Qendrore muslimanët e hershëm e njihnin si “Vendet pas lumit”.

Këto vende ndodheshin midis lumit Xhihun – Amu Darja në jug, dhe lumit Sîhun – Syrdarja, që tani ndodhet në veri të Kazakistanit. Banorët e atyre vendeve ishin paganë me origjinë turke.

Zona karakterizohet nga bollëku i ujit, për shkak të pranisë së lumenjve Xhihun dhe Sîhun, dhe degëve të tyre të shumta, gjë që ndihmoi në pjellorinë e rajonit, bollëkun e bujqësisë dhe të zhvillimit të jetës në të, dhe tërhoqjen popullsisë drejt saj.

“Vendet përtej lumit”, në kohën e luftërave islame, mund të ndahen në disa rajone ose mbretëri të pavarura:

1- Krahina e “Takharistanit”, e cila ndodhet në të dy brigjet e lumit Xhihun – Amu Darja.

2- Krahina Al-Sogd, dhe qytetet më të njohura të tij janë: Buhara dhe Samarkand.

3- Krahina e Hauarizmit, që përfshin deltën e lumit Xhihun – Amu Darja (sot i perket Uzbekistanit dhe Turkmenistanit).

4- Rajoni “Al-Khil”, në pjesën e sipërme të lumit Xhihun – Amu Darja.

5- Rajoni Ferghana, në brigjet e lumit Sîhun – Syrdarja.

6- Rajoni Shash, gjithashtu në brigjet e lumit Sîhun – Syrdarja, i njohur sot si Tashkent, që është sot kryeqyteti i Uzbekistanit.

Muslimanët kanë hyrë në këtë rajon disa herë, që nga kalifati i Othman ibn Affanit (r.a), (vitet 23-35 hixhri). Në kohën e Kalifatit Umejad, një numër komandantësh e sulmuan këtë rajon, si Ubejdullah ibn Zijad, Saïd ibn Othman ibn Affan, El-Muhal’leb ibn Ebi Sufra, dhe

SHESHI REGISTAN, SAMARKAND



dy djemtë e tij: Jezidi dhe El-Mufaddal. Fushatat e këtyre komandantëve nuk rezultuan me fitore. Konfliktet dhe përçarjet që pasuan vdekjen e Muavije ibn Ebi Sufjan (r.a), (viti 60-72 hixhri), u reflektuan në suksesin e luftërave në këtë rajon, dhe muslimanët u vunë në pozitë mbrojtëse, pasi turqit përfituan nga këto konflikte mes muslimanëve. Kështu ata i sulmuan tokat e Islamit, edhe i nxitën banorët e atyre vendeve që kishin bërë marrëveshje paqeje me muslimanët, të ngriheshin në revoltë. Në disa nga sulmet e tyre, ata arritën afër Nejsaburit, në Khorasan, dhe muslimanët humbën shumë nga zonat që i kishin pasur nën kontroll.

Sapo Abdulmelik ibn Mervan (65-86 hixhri) arriti të eliminonte kundërshtarët e tij, ai filloi t'i kushtonte vëmendjen e duhur zgjerimit të Islamit. Fakti që ai kishte lindur në territorin e Irakut, ishte çelësi i suksesit në frontin lindor.

Faza vendimtare në marrjen e atyre zonave dhe stabilitetin në to, filloi me marrjen e udhëheqjes së ushtrive muslimane dhe mandatin e provincës së Horasanit dhe të Vendeve të Lindjes (në vitin 85 hixhri), nga Kutejbe ibn Muslim El-Bahilij, i cili qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 99 të hixhretit.

Kutejbe ibn Muslim, Zoti e mëshiroftë, nuk ishte vetëm udhëheqës ushtarak, por përveç kësaj ishte burrë shteti, politikan, rregullator dhe administrator. Pasi mori në dorë punët e shtetit, ai punoi për eliminimin e konflikteve fisnore, dhe i bashkoi udhëheqësit e tyre nën një fjalë të vetme, siç punoi gjithashtu edhe për të fituar besimin e popullit vendas të Horasanit, dhe u tregua i sjellshëm me ta, i afërt, dhe u besoi atyre funksione të larta, kështu që të gjithë e qetësuan dhe i besuan atij dhe udhëheqjes së tij.

Fazat e fitores së Kutejbe ibn Muslimit në luftën me "Vendet përtej lumit"

Lufta e Kutejbe ibn Muslimit në marrjen e "Vendeve përtej lumit", kaloi

nëpër katër faza (vitet 86-96 hixhri), ku në secilën prej tyre arriti një fitore përfundimtare mbi njërin nga ato zona të mëdha.

FAZA E PARË: VITET 86-87 H

Në këtë fazë, Kutejbe mori provincën e Takharistanit. Me marrjen e kësaj zone, Kutejbe fitoi një famë të madhe në ato vende, dhe mbretërit e atyre anëve, sapo dëgjonin për marshimin e tij drejt tyre, nxitonin ta takonin dhe të kërkonin të bënë marrëveshje paqeje me të.

FAZA E DYTË: VITET 87-90 H

Në këtë fazë, Kutejbe mori të gjithë provincën e Buharasë, pas luftimeve të ashpra dhe fushatave të tij të njëpasnjëshme kundër saj.

FAZA E TRETË: VITET 91-93 H

Në këtë fazë ai përfundoi marrjen e gjithë pellgut e lumit Xhîhun – Amu Darja: Sixhistanin në vitin 92 H, dhe provincën e Havarizm-it në vitin 93 H. Puna e tij u kurorëzua me marrjen e Samarkandit, qytetit më të madh të "Vendeve përtej lumit".

Nga gjërat e bukura që transmetohen për marrjen e Samarkandit, është se kur muslimanët hynë në të, ata i nxorën idhujt që gjetën atje dhe i dogjën, ndërkohë që banorët e Samarkandit besonin se kush i nëpërkëmbte ata, shkatërrohej. Por, kur muslimanët i dogjën ata, dhe nuk pësuan asnjë dëmtim, shumë nga banorët e atij vendi hynë në Islam.

FAZA E KATËRT: VITET 94-96 H

Në këtë fazë, Kutejbe e kaloi lumin Sîhun-Syrdarja, dhe i mori tri mbretëritë Syrdarjane: Shash, Ashrusana, dhe


Ferghana. Pastaj ai hyri në tokat e Kinës dhe depërtoi në provincën Xinjiang, e arriti në rajonin Kashgar, të cilin e bëri një bazë Islame, dhe nga aty u përgatit për të marrë Kinën. Por vdekja e Haxhaxh ibn Jusuf Eth-Thekafij (95 H), dhe vdekja e kalifit El-Velid ibn Abdulmelik (96 H), e bëri atë të ndalonte në këtë pikë, e megjithatë, ai e detyroi mbretin e Kinës të paguante xhizjen.

Popujt e këtyre vendeve fillimisht nuk e njihnin Islamin, dhe mendonin se muslimanët kishin ardhur vetëm për të grabitur begatitë e vendit të tyre, gjë që i bëri ata të rezistonin ashpër. Por, kur e kuptuan se muslimanët nuk ishin pushtues, por udhërrëfyes që po sillnin Islamin tek ata, ata e përqaftuan këtë fe dhe besuan në parimet e saj.

Orientalisti hungarez Armin Vambéry thotë: "Buhara, e cila u rezistoi arabëve në fillim me një rezistencë të dhunshme, u hapi atyre dyert për të ardhmen, për t'i prituri ata, dhe bashkë me ta edhe mësimet e profetit të tyre Muhammed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Mësimet, të cilat në fillim u pritën me kundërshtime të forta nga njerëzit, më pas u pranuan prej tyre, dhe mbrojtën me një xheloz të madhe. Kjo do të na bënte të shikojmë se si sot Islami - i cili në pjesë të tjera të Azisë ka ardhur duke u dobësuar - në Buhara (viti 1873 e.j) ka marrë imazhin që ai e kishte në kohën e Kalifëve të Drejtë.".

Nuk ka dyshim se ky mejdan – mejdani i luftës në "Vendet përtej lumit" – ka qenë një nga mejdanët më të ashpër të luftës, dhe s'ka pasur asnjë mejdan lufte më të ashpër sesa lufta me popujt turq, por, pas përpjekjeve të njëpasnjëshme, ato vende u shndërruan në "Shtëpi të Islamit", dhe në një periudhë të mëvonshme u bënë "Qabeja" e shkencës dhe e dijetarëve. Në ato vende u krijuan qendra shkencore dhe kulturore, të tilla si: Buhara, Belkhi, Samarkandi, Nejsaburi, Herat, Marv, Er-

QYTETI BUHARA



Ra'j, Xhorxhan, Sarakhs, Taberistan, e të tjerë. Këto qytete nxorën një numër të madh dijetarësh, me të cilët u ndriçua ymeti musliman, dhe emrat e tyre u bënë të famshëm në të gjithë botën.

Samarkandi është kryeqyteti historik i Transoksianës – Vendeve përtej lumit, ose Azisë Qendrore. Disa eksplorues arabë e përshkruan atë qytet si "rubinin" e shtrirë në bregun jugor të lumit Zeravshan. Ky qytet hyri në Islam nga duart e Kutejbe ibn Muslim, në vitin 93 H / 711.

Nga ky qytet kanë dalë dijetarë të shquar, mes të cilëve mund të përmendim dijetarin Muhammed ibn Mahmud El-Maturidi, i njohur si Ebu Mansur El-Maturidi (v. 333 H – 944 e.j), jurist dhe orator i famshëm, i lindur në Maturid, një nga qytetet e Samarkandit dhe njihet si autori i librit Sherh kitab el-Fikh El-Ekber, të Imam Ebu Hanifes.

Një tjetër dijetar i shquar i kësaj zone është edhe Nasr ibn Muhammed ibn Ibrahim Es-Samarkandi (v. 375 H – 985 e.j), që ishte një interpretues i Kur'anit, dhe që njëhej si Ebu El-Lejth Es-Samarkandi, autor i librit "Tenbîh El-Gafîlîn" (Tërheqja e vëmendjes ndaj të pakujdesshmëve), dhe Kitab El-Fetava (Libri i fetvave).

Buhara është një tjetër qytet i rëndësishëm i Uzbekistanit, në të cilin Islami hyri në vitin 54 H / 674, nën udhëheqjen e komandantit musliman Ubejdullah ibn Zijad ibn Ebîhi, gjatë epokës së Umejadëve. Por, përfundimisht ky qytet hyri nën kalifatin islam nga Kutejbe ibn Muslim, në vitin 90 H / 708.

Ndër dijetarët më të famshëm muslimanë të dalë nga ky qytet është dijetari Muhammed ibn Isma'îl El-Buhari, (v.256 H / 869). Ai shkroi veprën më të famshme të Hadithit Profetik të të gjitha kohërave, të njohur si Sahîh El-Buhari.

Ndër personalitetet e Buharasë është edhe filozofi dhe mjeku Ebu Ali El-Husejn ibn Abdullah ibn Sîna, i njohur si Ibn Sina (Avicena; v. 428 H / 1036). Ndër librat e tij janë: El-Isyarat vet-Tenbîhat(Shenjat dhe Paralajmërimet) në filozofi, dhe El-Kanun(Ligji), në mjekësi.

Qyteti Tirmidh, i Uzbekistanit, gjendet përgjatë rrjedhës së lumit Xhîhun-Amu-Darja, afër kufirit me Afganistanin. Muslimanët hynë në të në vitin 56 H / 676, kur Saîd ibn Othman ibn Affan e mori atë pa luftë, por përfundimisht hyri nën kalifatin islam nga Kutejbe ibn Muslim, rreth vitit 93 H / 711.

Me këtë qytet identifikohet dijetari i shquar Muhamed ibn Isa Et-Tirmidhi

(v. 279 H / 892), nxënësi i Buhariut të famshëm, dhe autor i veprës së njohur në fushën e Hadithit Profetik Sunen Et-Tirmidhi, edhe i veprave të tjera.

Havarizmi është një qytet që ndodhet në perëndim të Uzbekistanit, dhe aktualisht njihet si Khiva. Khiva hyri në Islam nga duart e Kutejbe ibn Muslim, në vitin 93 H / 711. Nga dijetarët e shquar të dalë nga ky qytet është Muhamed ibn Ahmed El-Bîruni, i njohur si Ebu Er-Rejhan El-Bîruni (v. 440 H / 1048).

Ai ishte një dijetar njohës i mirë i feve, astronom, matematikan dhe mjek, i cili shkroi më shumë se 146 libra, ku një nga ata është vepra Kitab Es-Sajdale (Libri i Farmacisë). Po këtij qyteti i përket edhe dijetari Muhamed ibn Musa El-Havarizmi (v. 236 H / 850j), matematikani i shquar dhe themeluesi i shkencës së algjebërës dhe logaritmeve, dhe e tij është vepra Kitab El-Xhebr vel-Mukabele(Llogaritja sipas Plotësimit dhe Balancimit).

Gjithashtu, nga ky qytet doli edhe dijetari i shquar Mahmud ibn Omer El-Havarizmi, i njohur si Ebul-Kasim Ez-Zemekhshari (v. 538 H / 1143), autor i komentimit të Kuranit, Tefsîr El-Keshshaf, dhe i veprës Esas El-Belaga.

Shash (Tashkent) është një nga qytetet kryesore të Uzbekistanit të sotëm, që ka hyrë në Islam nga duart e Kutejbe ibn Muslim-it gjithashtu, rreth vitit 94 H / 712. Një nga dijetarët e këtij qyteti ka qenë Ahmed ibn Muhamed ibn Is'hak Esh-Shashi, autori i librit Usul Esh-Shash"(Bazat e El - Shashit).

Nesef është një qytet që ndodhet në Uzbekistan, por quhet edhe Nakhshab. Ky qytet hyri në Islam pa luftë, nga duart e Kutejbe ibn Muslim-it, në vitin 92 H / 710. Nga ky qytet ishte juristi hanefi, Abdullah ibn Ahmed ibn Mahmud En-Nesefi (v. 710 H / 1310), që njëhej me emrin Hafidh Ed-Dîn (mbrojtësi i fesë), autori i veprës së tefsirit Medarik Et-Tenzil ve Hakaik Et-Te'vil"(Perceptimet e Shpalljes dhe të Vërtetat e Interpretimit), i njohur si Tefsir En-Nesefi, siç është autor edhe i shumë veprave të tjera. Po nga ky qytet dolën edhe shumë dijetarë të tjerë të njohur të Islamit.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.state.gov>
<https://en.wikipedia.org>
<https://www.gov.uz>
<https://islamansiklopedisi.org.tr/uzbekistan#3-kultur-ve-medeniyet>
<https://islamstory.com>
<https://ar.wikipedia.org>
<https://www.marefa.org>

PRESIDENTI ERDOĞAN PËRURON MEDRESENË AJASOFJA FATIH NË STAMBOLL



Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, përuroi Medresenë Ajasofja Fatih në Stamboll, raporton Anadolu Agency (AA).

Shkolla fetare e ka marrë emrin nga Fatih, titulli i dhënë Sulltan Mehmetit II, i cili çliroi Stambollin në vitin 1453.

"Ne kemi ndërmarrë një hap shumë të rëndësishëm për të bartur të kaluarën tonë madhështore në të tashmen dhe të ardhmen dhe për ta bashkuar atë me popullin tonë", tha presidenti Erdoğan në ceremoninë e inaugurimit.

"Pas çlirimit të Stambollit, ky vend u vu në shërbim si medreseja e parë e qytetit, pranë Ajasofjes", shtoi Erdoğan.

Ai tha se shkolla vazhdoi të funksiononte deri në vitin 1924 me mirëmbajtje, riparime dhe ndërtime gjatë periudhave të ndryshme, por më vonë u shkatërrua nga "ata që donin të fshinin historinë e pasur të vendit".

Erdoğan tha se medreseja do të jetë përsëri një qendër arsimore, e operuar nga Universiteti Fatih Sultan Mehmet.

"Medreseja Ajasofja Fatih, e cila ka qenë e rëndësishme në trajnimin e dijetarëve të panumërt për gati katër shekuj e gjysmë, do të shërbejë si qendër arsimore tani e tutje. Shpresoj që studiuesit, intelektualët, shkencëtarët dhe studiuesit e së nesërme të trajnohen këtu", tha presidenti turk.

Ajasofja u ndërtua në vitin 532 të erës sonë dhe u shndërrua në një xhami pas çlirimit nga sulltani i shtatë, i cili më vonë krijoi një temel xhamie.

Në kuadër të ndërtesës, ai urdhëroi gjithashtu ndërtimin e një minberi, mihrabi dhe biblioteke.

Ajasofja shërbeu si kishë për 916 vjet dhe 86 vjet si muze. Por nga viti 1453 deri në vitin 1934, ose gati 500 vjet, ajo shërbeu si xhami. Në vitin 1985, ajo u shtua në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Ajasofja është ndër destinacionet kryesore turistike të Turqisë dhe mbetet e hapur për vizitorët vendas dhe të huaj. (www.radiojehona.al)

MYFTIU I SHKODRËS, VIZITË KORTEZIE KRYETARIT TË RI TË BASHKISË SHKODËR



Paraditën e të enjtes, më 19 maj 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë kortezie në zyrën e kryetarit të ri të Bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia.

Myftiu i Shkodrës i përcolli kryebashkiakut urimet më të përzemërta me rastin e zgjedhjes në drejtimin me përgjegjësi të Bashkisë Shkodër.

Gjatë takimit, Myftiu konfirmoi dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin me Bashkinë e Shkodrës dhe personalisht me kryetarin Spahia në interesin më të mirë të komunitetit.

Në një prononcim mediatik Imam Muhamed Sytari tha: "I shpreha kryebashkiakut, Dr. Bardh Spahia se Myftinia Shkodrës do të jetë siç ka qenë gjithmonë në krah të kryetarit të bashkisë për projekte dhe iniciativa të dobishme për qytetin e Shkodrës, për qytetarët pa asnjë dallim si dhe dëshirën tonë të madhe që këtë mozaik të bukur që Zoti i ka dhënë Shkodrës, këtë harmoni dhe diversitet të vlerave me u përkujdesë

që me e ruajt, me e trashëgu dhe me çu gjithnjë e më përpara, duke marrë gjithsecili përgjegjësitë e veta si dhe duke bërë më të mirën e mundshme...".

Ndërsa, kryetari i Bashkisë, z. Bardh Spahia, falënderoi Myftiun Imam Muhamed Sytari për vizitën dhe urimet, duke e siguruar se bashkëpunimi me komunitetet fetare në Shkodër në përgjithësi, por atë mysliman në veçanti do të jetë i vazhdueshëm e konkret.

Ndërkohë z. Spahia vlerësoi shumë kontributin e Myftiut dhe të Myftinisë në shërbim të jetës fetare dhe atë sociale në qytetin e Shkodrës, por edhe të ruajtjes së harmonisë dhe bashkëjetesës që është një simbol i vyer për mbarë Shqipërinë dhe përtej saj...

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i dhuroi Kryetarit të ri të Bashkisë Shkodër, një kopje të Kur'anit me përkthim të kuptimeve të tij në gjuhën shqipe dhe disa prej botimeve të tij.

Në këtë takim, Myftiu shoqërohej nga z. Arben Halluni dhe z. Lavdrim Hamja.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

*"Përhapeni
selamin,
ushqeni me
ushqim dhe
jetoni
si vëllezër,
ashtu si ju
ka urdhëruar
Allahu!"*

(Transmetuar nga Ibn Maxheh).

MYFTIU I SHKODRËS: "MEDRESEJA 'ALAUDIN', E SHQUAR EDHE PËR MBROJTJEN E ÇËSHTJES KOMBËTARE!"

Ditën e xhuma, më 20 maj 2022, nëpërmjet foltores së xhamisë Parrucë, në dersin e xhumasë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i uroi mirëseardhjen në Shkodër mësuesve dhe maturantëve të nderuar të Medresesë "Alaudin", Prishtinë, që ishin për vizitë në qytetin e Shkodrës.

Në fjalën e tij, ndër të tjera Myftiu theksoi se: "Medreseja 'Alaudin' është një shkollë historike. Është një medrese që i bën nder të gjitha medreseve të trojeve shqiptare. Një medrese e njohur dhe e shquar, jo vetëm për përhapjen e dijes, por edhe për mbrojtjen e çështjes kombëtare edhe në një ndër momentet më të vështira historike të vëllezërve tanë në Kosovë.



Nëpërmjet këtij falënderimi dhe mirënjohjeje, patjetër që përulemi me respektin më të madh dhe i lutemi Allahut të Madhëruar për ata vëllezër të nderuar që kemi në Prishtinë e Kosovë, të cilët përpiqen pa ndërprerje, siç historikisht janë përpjekur, për të mirën e Thirrjes Islame dhe të mirën e çështjes tonë kombëtare!

I uroj mirëseardhjen dhe jam shumë i gëzuar që janë sot me ne, djemtë tanë të dashur, maturantët e Medresesë 'Alaudin'...!"

Pas përfundimit të ceremonisë së ditës së xhumasë, Myftiu zhvilloi edhe një takim të ngrohtë me maturantët dhe mësuesit e nderuar edukatorë: Muharrem Tërnavë, Muhamed Stublla, Shefqet Krasniqi dhe Shkëlzen Hoxha.

MYFTIU PRITI KRYETARIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR TË ARIZONËS, IMAM DIDMAR FAJA

Ditën e mërkurë, më 25 maj 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, mikun e shtrenjtë Imam Didmar Faja, kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili ndodhet këto ditë për një vizitë në vendlindje.

Gjatë takimit, Myftiu Sytari e falënderoi të nderuarin Imam Didmar Faja për angazhimet dhe kontributet e mëdha në gjallërimin e jetës fetare në shtetin e Arizonës, por jo vetëm, ku jeton dhe vepron prej vitesh.

Myftiu theksoi se gjurmët e shqiptarëve gjithandej nëpër botë, po dëshmojnë rolin e tyre të madh në përhapjen e vlerave islame, shembullin e besimit dhe harmonisë, duke i kthyer ata në burim sigurie dhe garancie në rang botëror.



Nga ana e tij, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës e njohu Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, me aktivitetet e larmishme dhe misionin fisnik të institucionit që ai drejton në Arizona, si dhe projektet e

reja në dobi të rritjes së bashkëpunimit në mesin e muslimanëve atje.

Imam Didmar Faja, ka lindur në Shkodër dhe prej 23 vitesh jeton dhe vepron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“PËRSHPIRTJE RAMAZANI” AKTIVITET RRETH ATMOSFERËS SË RAMAZANIT 1444/2022

Ditën e shtunë, më 21 maj 2022, pas namazit të akshamit, Myftinia Shkodër zhvilloi në oborrin e xhamisë së Parrucës aktivitetin me temë: “Përshpirtje Ramazani”.

Fillimisht u bë falja e namazit të akshamit me xhemat në xhami nën drejtimin e H. Durim Kasemit. Aktivitetin e drejtoi teologu Arben Halluni, i cili solli në vëmendje shpirtin e mirësisë të muajit të Ramazanit, që këtë vit ishte më i veçantë, sesa dy vitet e kaluara, për shkak të lirimit nga masat shtrënguese nga pandemia e Covid-19.

Më pas fjalën e mori Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, i cili ndër të tjera tha, se: “Edhe pse nuk ka kaluar shumë kohë nga muaji i Ramazanit, e rëndësishme është, që myslimani të mos ndahet asnjëherë nga thelbi, misioni dhe shpirti i muajit të Ramazanit. Gjithsesi, ky muaj në dëshmoi, nëpërmjet mirësive të pafund të Allahut të Madhëruar për ne, se ne jemi një familje e madhe e besimit dhe e vlerave; dhe se ky Islam është një taban i fortë që e mban gjallë këtë popull dhe këtë komb”.

Myftiu tha, se është për t’u theksuar puna dhe angazhimi i rinisë gjatë Ramazanit dhe se, e nisëm këtë muaj



si Muaji i Familjes dhe e mbyllëm me Iftarin e Familjes, për të treguar mirësinë e madhe të këtij muaji të begati në raport me familjen, por edhe për mbarë shoqërinë.

Pastaj e mori fjalën H. Durim Kasemi, imam i xhamisë së Parrucës, i cili solli në vëmendjen frymën e mirësisë, të bashkëpunimit dhe të kënaqësisë, që patën iftaret e shtruara në oborrin e xhamisë së Parrucës, ku u shtruan 25 iftare me pjesëmarrjen e 2500 personave.

Ai theksoi se përtej iftareve, këtë Ramazan u shtruan edhe disa syfyre për besimtarët, të cilët vinin për të falë

namazin e natës dhe namazin e sabahut me xhemat.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë personat, të cilët morën pjesë në organizimin e projektit të sofrës së iftareve, të shtruara kryesisht në oborrin e xhamisë së Parrucës, biznesmenët shkodranë, të cilët kontribuan financiarisht për këto iftare, e veçanërisht grupin organizativ H. Durim Kasemi, z. Erion Llazani, H. Ervil Kuçi, etj dhe grupin e të rinjve, të cilët punuan me përkushtim për mbarëvajtjen e këtij projekti me vlerë dhe dobi.

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë të gjithë me të mira.



MEJTEPI I IM... XHAMIA ZOGAJ

PAK HISTORI:

- Xhamia Zogaj, ndodhet në Njësinë Administrative “Rrethina”, Shkodër.

- Aktualisht, përbëhet prej 70 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Qotaj, Rupa, Balani, Neziri, Hasa, Turishta, etj.

- Në vitin 1990 banorët e Zogajve morën xhaminë e tyre të vjetër, e cila në kohën e regjimit monist shërbeu si pjesë e një punishte artistike. Ndërsa në vitin 2002, në sajë të kontributit të të gjithë banorëve të zonës, por edhe nga besimtarë të ndryshëm të qytetit, xhamia u rikonstruktua plotësisht.

- Imamët dhe mësuesit e mejtepeve që kanë shërbyer në këtë xhami pas



rihapjes së fesë, nga viti 1990-2002 - H. Kaçubeti, nga viti 2002 dhe në vazhdim H. Ylber Rupaj si dhe mësuesja Hadixhe Nasufi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 18 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2022 është rreth 270 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadër të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, në vigjilje të muajit të Ramazanit, drejtuesi dhe inspektori i

arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Zogaj.

Teologu Halluni, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve, etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri i mësimave të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Në këtë takim ishin edhe mësuesit e mejtepeve H. Ylber Rupa dhe znj. Hadixha Nasufi.





KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISE
MYFTINIA SHKODËR

www.myftinia-shkoder.org



Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

**“Më i miri
prej jush është ai
që është
MË I MIRË
PËR FAMILJEN E TIJ!”**

(Transmetuar nga Tirmidhiu)



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org